



Republika e Kosovës
Republika Kosovo -Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV
Kryesia e Kuvendit

P-023

Prishtinë, më 28 qershor 2011, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, TË MBAJTUR MË 28 QERSHOR 2011

Në mbledhje morën pjesë: Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit, Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Petar Miletqi dhe Enis Kervan, nënkryetarë të Kuvendit;

Nga grupet parlamentare: Adem Grabovci, Myzejene Selmani dhe Ismet Beqiri.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Kabineti i Kryetarit të Kuvendit: Mehmet Hajrizi dhe Skënder Reçica;

Nga Administrata e Kuvendit: Daut Beqiri, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Sherif Konjufca.

Nga OSBE-ja: Floriana Shala.

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar i Kuvendit.

Kryetari hapi mbledhjen dhe i njoftoi të pranishmit me propozimin e rendit e ditës.

Ai propozoi që rendit të ditës t'i shtohen edhe shtatë pika shtesë.

Kryesia, me propozim të kryetarit, miratoi këtë:

R e n d d i t e

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 qershor 2011,
2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen e ardhshme plenare,
3. Shqyrtimi i mocioneve, të rekomandimeve dhe të kërkesave.

1. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur 21 qershor 2011

Kryesia miratoi, pa vërejtje, Procesverbalin e mbledhjes së Kryesisë, të mbajtur më 21 qershor 2011.

2. Propozimi i rendit të ditës për mbledhjen plenare që do të mbahet më 30 qershor 2011.

Kryesia, pasi shqyrtoi përgatitjet e nevojshme për secilën pikë veç e veç, me pëlqimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, vendosi që mbledhja e Kuvendit të mbahet më 30 qershor 2011, me këtë:

R e n d d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Interpelanca e Kryeministrit të Kosovës, z. Hashim Thaçi, sipas kërkesës së Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për dizajnin industrial,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për patenta,
7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera,
8. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për markat tregtare,
9. Shqyrtimi i Raportit të punës së Komisionit të Ndihmës Juridike,
10. Shqyrtimi i propozimit të Komisionit sd-hoc parlamentar për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media.

3. Shqyrtimi i rekomandimeve dhe të kërkesave:

3.1 Raporti i Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës për vizitën zyrtare të realizuar në Kroaci

Kryesia u njoftua për vizitën zyrtare të Komisionit për amendamentimin e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të realizuar në Kroaci, prej datës 13-15 qershor 2011.

3.2 Propozimi i Grupit Parlamentar të Koalicionit për Kosovë të Re, për zëvendësimin e anëtarit të Komisionit të Rregullores së Punës

Me kërkesë të propozuesit, kjo pikë u shty për mbledhjen e radhës.

3.3 Informatë mbi pengesat në përmbushjen e misionit kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit

Kryesia, pasi shqyrtoi Informatën e cekur më lart, nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Informata mbi pengesat në përmbushjen e misionit kushtetues të Institucionit të Avokatit të Popullit i dërgohet për shqyrtim Komisionit për Legjislacion dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa.

3.4 Kërkesa e Komisionit ad-hoc për lejimin e kompensimit për anëtarët e komisionit dhe të stafit mbështetës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi për anëtarët e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e anëtarëve për Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media, në këtë përbërje: Berat Buzhala, Lirije Kajtazi, Alma Lama, Teuta Haxhiu, Myzejene Selmani, Jeton Svirca, Petar Miletqi, Fikrim Damka, Rada Trajković, Duda Balje, Danush Ademi, Emilija Redžepi, Hamza Balje, Xhevdet Neziraj, Etem Arifi, Sasa Djokić, Mursel Haljilji dhe Albert Kinolli, anëtarë të Komisionit.

2. Kompensimi të bëhet në shumën prej 50 euro, për një mbledhje, sipas evidencës për secilin anëtar.

3.5 Kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kompensimin e mëditjeve për deputetin Latif Gashi lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Në bazë të nenit 21, paragrafi 2 të Ligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetëve, **Refuzohet** kërkesa e Komisionit për Buxhet dhe Financa për kompensimin e mëditjeve për deputetin Latif Gashi dhe deputetët tjerë pjesëmarrës, lidhur me vizitën zyrtare të realizuar në Shqipëri, nga data 15 deri më 20 qershor 2011.
2. Deputetët pjesëmarrës në këtë Grup punues kërkesën për kompensim mund t'ia parashtrojnë Qeverisë së Kosovës.

3.6 Propozimi i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës për emërimin e një anëtari në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media

Propozimi i cekur më lart u shty për njëerën nga mbledhjet e radhës të Kryesisë.

3.7 Kërkesë për aprovimin e mëditjeve për udhëtimin zyrtar të realizuar në Shqipëri

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet kompensimi i mëditjeve për deputetët e Kuvendit, në këtë përbërje: Nait Hasani, Sevdije Lama, Njazi Idrizi dhe Daut Haradinaj, për vizitën e realizuar në Shqipëri, prej datës 19 deri më 22 qershor 2011.

3.8 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Srebrenicë të Bosnjës dhe Hercegovinës

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Rasim Demiri, Duda Balje, Albert Kinolli, Mufera Shinik, Enis Kervan dhe Fikrim Damka, në Srebrenicë, Bosnjë dhe Hercegovinë, prej datës 9 deri më 12 korrik 2011.

2. Mbulimin e shpenzimeve të transportit dhe kompensimi i mëditjeve shtesë të bëhet nga Fondi i mjeteve të Grupit Parlamentar “6+”.

3.9 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi i anëtarëve të Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, në këtë përbërje: Zenun Pajaziti, Lutfi Zharku, Myzejene Selmani dhe Biserka Kostiq, si dhe i stafit mbështetës Armend Ademaj dhe Muhamed Morina, për të marrë pjesë në seminarin, me temën: “Transporti dhe infrastruktura në kontestin regjional”, që do të mbahet në Bruksel, Belgjikë, prej datës 11 deri më 14 korrik 2011.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit për të lartpërmendurit në paragrafin (1) të këtij vendimi, mbulohen nga Kuvendi i Kosovës, ndërsa do të rimbursohen nga Parlamenti Evropian. Mëditjet shtesë përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.10 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Mal të Zi

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetes së Kuvendit znj. Flora Brovina në Mal të Zi, prej datës 28 qershor deri më 1 korrik 2011.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga Qeveria e Kosovës, ndërsa mëditjet shtesë për të lartpërmendurën në paragrafin (1) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

3.11 Kërkesë për lejimin e udhëtimit zyrtar në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në Bruksel

Kryesia, pasi shqyrtoi kërkesën e cekur më lart, mori këtë:

V E N D I M

1. Lejohet udhëtimi zyrtar i deputetëve të Kuvendit, në këtë përbërje: Elmi Reçica, Vjosa Osmani dhe Jasmina Zhivković në Asamblenë Parlamentare të NATO-s, në Bruksel, prej datës 10 deri më 14 korri 2011.
2. Shpenzimet e udhëtimit dhe të akomodimit mbulohen nga organizatori-OSBE-ja, ndërsa mëditjet shtesë për të lartpërmendurit në paragrafin (1) të këtij vendimi, përballohen nga buxheti i Kuvendit të Kosovës.

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë, në orën **11:50** minuta.

Kryetari i Kuvendit,

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:
Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale.